VENDIM
Nr. 115, datë 3.6.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OST SHA PËR MIRATIMIN E "RREGULLORES PËR ALOKIMIN E KAPACITETEVE AFATGJATA"

Në mbështetje të neneve 16, 19 germa "e", 20, germa "a", 23, pika 1, germa "a", 65, pika 1, dhe 66, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 26 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016 të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE); Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.6.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1407/1 prot., datë 21.5.2025, të përgatitur nga drejtoritë teknike, "Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për miratimin e 'Rregullores së alokimit të kapaciteteve afatgjata'",

konstatoi se:

- Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. ka depozituar në ERE, me shkresën nr. 1752 prot., datë 20.3.2025, kërkesën për miratimin e "Rregullores për alokimin e kapaciteteve afatgjata".

- Në këtë kërkesë, OST-ja nënvizon, se në përputhje me vendimin nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë, janë përfshirë në *Acquis Communautaire* të Traktatit një sërë aktesh rregullatore të BE-së, përfshirë rregulloren (BE) 2016/1719 të Komisionit Evropian "Për miratimin e udhëzuesit për alokimin e kapaciteteve afatgjata (FCA Guideline)", pjesë e Paketës së Energjisë së Pastër për të Gjithë Evropianët.

- Projektrregullorja synon të krijojë një kornizë të harmonizuar për alokimin ndërkufitar të të drejtave të transmetimit në periudha afatgjata, përmes metodologjive të harmonizuara dhe ankandeve të përbashkëta evropiane. Ajo përfshin rregulla për llogaritjen dhe ndarjen e kapaciteteve, zhvillimin e ankandeve, kompensimet dhe rikuperimin e kostove.

- Zbatimi i kësaj rregulloreje është një hap i rëndësishëm drejt integrimit të Shqipërisë në tregun rajonal dhe evropian të energjisë elektrike, duke rritur transparencën, efikasitetin dhe sigurinë e tregut afatgjatë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e "Rregullores së alokimit të kapaciteteve afatgjata".

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti